



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE
KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

MAJ, 2026

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin maj 2026 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara, dhe në disa raste edhe ato të dyshuara dhe të mundshme sipas përkufizimit të rastit.

1. Sëmundjet diarreike

Për muajin maj incidenca e sëmundjeve diarreike është 369.9 raste për 100,000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike me incidencë 369.6 / 100000 banorë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin maj 2026
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste maj 2026	Incidenca maj 2026 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	2	0.08
Shigellozë (Disenteri bacilare)	1	0.04
Toksiko-infeksione alimentare	4	0.17
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	8879	369.63
Sëmundje diarreike në total	8886	369.92

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit maj 2026 janë raportuar në total 285 raste të dyshuar me variçelë (incidenca 11.8/ 100.000 banorë). Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 76 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 149 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi

Gjatë muajit maj janë raportuar 60 raste të dyshuara nga të cilat janë konfirmuar 49 raste nga ana laboratorike me metodën ELISA. Incidenca në muajin maj është 2.03 raste /100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas datës së fillimit të rashit



Siç shihet edhe nga kurba epidemike, ka një qëndrueshmëri të rasteve gjatë muajit maj.

Tabela 2. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruthit sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Dibër	2	3.9
Durrës	10	6.5
Kukës	2	5.5
Lushnjë	1	1.1
Kurbin	1	2.9
Tiranë	32	5.3
Sarandë	1	2.6
Total	49	2.0

Rastet i përkasin kryesisht bashkisë Tiranë, por incidencën më të lartë e ka bashkia Durrës me 6.5 raste /100 000 banorë.

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruthit sipas grup-moshës

Grup-mosha,vite	Raste	Incidençë
0-4 vjeç	39	34.9
5-14 vjeç	3	1.1
15-24 vjeç	1	0.3
25-44 vjeç	5	0.9
45-59 vjeç	1	0.2
60 + vjeç		
Total	49	2.0

Shumica e rasteve janë të grup-moshës pediatrike 0-14 vjeç, 43 raste (87.7%) janë të pavaksinuar dhe 1 (2%) rast janë me dy doza vaksine FRP, 2 raste (4.1%) me një dozë, dhe 3 raste (6.1%) nuk ju dihet statusi i vaksinimit. Të dhënat e vaksinimit janë verifikuar në sistemin elektronik të informacionit mbi vaksinat (SIV).

Gjithashtu 43 (87.7%) raste janë të shtruar në spital, ndërsa 6 (12.2%) prej tyre u ndoqën në rrugë ambulatorë.

Hetimi epidemiologjik i rasteve është kryer nga shërbimi i epidemiologjisë në NJVKSH përkatëse, ku janë identifikuar kontaktet dhe janë marrë masat e kontrollit të infeksionit.

3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin maj janë raportuar 24 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në këtë muaj është 1rast/100 000 banorë në vend.

Prej tyre 16 raste janë të gjinisë mashkull (66.6%) dhe 8 femra (33.4%).

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banorë) me HBV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Bulqizë	2	7.5
Dibër	2	3.9

Lushnjë	1	1.1
Tiranë	18	3.0
Vlorë	1	1.0
Total	24	1.0

Në muajin maj rastet janë të shpërndara në disa bashki (tabela 1) ku numrin më të lartë e ka Tirana me 18 raste, ndërkohë incidenca është më lartë në Bulqizë me 7.5 raste /100 000 banorë.

Tabela 5. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banorë) me HBV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç		
25-44 vjeç	12	2.04
45-59 vjeç	8	1.64
60 + vjeç	4	0.60
Total	24	1.00

Rastet në muajin maj i përkasin grup-moshës adulte (tabela 2) dhe mungesa e tyre në grup-moshat pediatrike është në sajë të vaksinimit ndaj HBV-së në këto grup-mosha. Incidenca është më e lartë në grup-moshën 25-44 vjeç dhe përkatësisht 2.04 raste për 100 000 banorë. Të gjitha rastet e konfirmuara të raportuara janë testuar për arsye diagnoze, dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut B.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin maj janë raportuar 7 raste të konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV për këtë muaj është 0.3 raste /100000 banorë.

Katër raste (42.8%) i përkasin gjinisë mashkull dhe 3 raste (42.8%) asaj femër.

Tabela 6. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Lushnjë	1	1.1
Korçë	1	1.1
Tiranë	5	0.8
Total	7	0.3

Numri më i lartë i raportuar është në bashkinë Tiranë (5 raste).

Tabela 7. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç		
25-44 vjeç	1	0.2
45-59 vjeç	2	0.4
60 + vjeç	4	0.6
Total	7	0.3


Gjatë muajit maj rastet janë të shpërndara në grup-moshat adulte (tabela 2) ku incidenca më e lartë i përket grup-moshës mbi 60 vjeç me 0.6 raste /100 000 banorë.

Të gjitha rastet e konfirmuara, të raportuara janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut C.

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit maj 2026 janë kryer 41 ekzaminime për HIV (24 meshkuj dhe 17 femra) prej të cilëve 16 raste (11 meshkuj dhe 5 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv (Grafiku 1).

Grafiku 3. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin maj 2026.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është: 9 raste Tiranë, 1 rast Durrës, 2 raste Korçë, 1 rast Pogradec, 1 rast Librazhd dhe 2 raste me shtetësi të huaj, me vendbanim të përkohshëm në vendin tonë (Grafiku 2).

Grafiku 4. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara në muajin maj 2026



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 0-15 vjeç, 4 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 5 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç, 3 raste i përkasin grup-moshës 55-64 vjeç dhe 2 raste i përkasin grup-moshës mbi 65 vjeç.

Rastet e konfirmuara janë referuar si më poshtë:

5 raste vijnë nga laboratorë/spitale privatë (2 raste Genius, 2 raste CAMBRIDGE dhe 1 rast INTERMEDICA).

4 raste vijnë nga Klinika Ambulatore Infektiv.


4 raste nga Shërbimi Infektiv /QSUT (pavionet).

3 raste nga pediatria/ QSUT (1 fëmijë dhe prindërit si ndjekje epidemiologjike nga fëmija).

Sifiliz

Gjatë muajit maj 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 8 raste të konfirmuara me Sifiliz, incidenca është 0.33 raste për 100000 banorë.

Grafiku 1. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 7 meshkuj dhe 1 femër.

Rastet vijnë nga bashkitë: Tiranë, Vlorë dhe Durrës.

INFEKSION NGA GONOKOKOU SI GONORRHE ETJ. (N. GONORRHOEAE)

Gjatë muajit maj është raportuar një rast i konfirmuar me N. Gonorrhoeae nga bashkia Tiranë, grup-mosha 25-34 vjeç.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit maj 2026 janë raportuar gjithsej 12 raste me tuberkuloz (TB). 10 raste janë pulmonare dhe 2 raste janë ekstrapulmonarë, të konfirmuara me ekzaminime laboratorike.

Rastet pulmonare janë të shpërndara përkatësisht: 4 në Tiranë, 1 në Dibër, 1 në Mirditë, 1 në Elbasan, 1 rast në Lezhë, 1 në Kukës, dhe 1 rast në Lushje.

Këtë muaj kemi 2 raste ekstrapulmonare në rrethin e Tiranës.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria dhe NJVKSH-të e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB këtë muaj janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 8. Shpërndarja e zoonozave në muajin maj 2026, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecizioë)

	Maj (raste 2026)	Incidenca (raste/100,000) 2026
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	0	0.00

Për muajin maj janë raportuar 4 raste Brucelozë përkatësisht: 2 nga Përmeti, 1 Dibër dhe 2 Tepelenë.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

7.2

Gjatë muajit maj 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 2 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin maj është 0.08 raste /100000 banorë.

Gjatë muajit maj 2026 janë raportuar zero raste vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 100% (2 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

7.3 Grip

Gjatë muajit maj janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 16 raste të dyshuara me Grip, nga të cilat asnjë rast nuk rezultuar pozitive për grip.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Meningit bakterial

Gjatë muajit maj 2026, nga Shërbimi i Pediatri në QSUT është raportuar 1 rast me meningit bakterial shkaktuar nga *Streptococcus pneumoniae*. Rasti është i gjinisë femërore, i përket grupmoshës 5–9 vjeç dhe ka vendbanim në Fier. Pas raportimit të rastit, u morën masat përkatëse të kontrollit dhe parandalimit, si dhe u krye hetimi epidemiologjik.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK
DEKSI